



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 11

Tiranë – E hënë, 29 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 13213/4562/2448, datë 16.3.2021	Për hapjen e procedurave të falimentimit për shoqërinë “Qendra Distribucion Ushqimor” sh.p.k..... 3
Njoftim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. 67, datë 26.3.2021	Për shpallje konkurrimi për një vend të lirë pune..... 12



VENDIM

Nr. 13213/4562/2448, datë 16.3.2021

**PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË
FALIMENTIMIT PËR SHOQËRINË
“QENDRA DISTRIBUCION
USHQIMOR” SHPK**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtar: Ervin Pollozhani,

asistuar nga sekretare gjyqësore Lusjana Fezollari, sot më datë 16.3.2021, mori në shqyrtim në seancë dhome këshillimi, çështjen administrative-civile me nr. 13213/4562/2448 regj. themeltar që u përket:

KËRKUES: Shoqëria “Marketing & Distribution” sh.p.k., me cilësinë e kreditorit me seli në Tiranë, adresa: Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, km 10, me përfaqësues ligjor z. Sokol Vehbi, përfaqësuar në gjykim me autorizim përfaqësimi datë 17.10.2019 nga av. Dritan Jahaj.

Shoqëria “Interlogistic” sh.p.k., me cilësinë e kreditorit me seli në Tiranë, rruga dytësore, autostrada Tiranë-Durrës, km 9, me përfaqësues ligjor z. Edmond Hido, përfaqësuar në gjykim me autorizim përfaqësimi datë 17.10.2019, nga av. Dritan Jahaj.

OBJEKTI: 1. Hapja e procedurave të falimentimit për shoqërinë “Qendra Distribucion Ushqimor” sh.p.k., me seli në Tiranë me adresë rruga “Luigj Gurakuqi”, pall. 89, shk. 1, kati 9, ap. 33, dhe adresë tjetër rruga “Themistokli Germenji”, pallati “Salltik”, shk. 1, kati 1, ap. 1, kodi postar 1010.

2. Caktimin e një administratori të përkohshëm të falimentimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 323, 334, 335 të K. Pr. Civile, ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligji nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

Gjykata, në vijim të veprimeve procedurale që lidhen me fazën e parë të procedurës për hapjen e procedurës së falimentit për shoqërinë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k.,

VËREN:

Se pala kërkuese, shoqëria “Marketing & Distribution” sh.p.k. dhe shoqëria “Interlogistic” sh.p.k. i janë drejtuar kësaj Gjykate, me kërkesën për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Qendra Distribucion Ushqimor” sh.p.k. dhe caktimin e një administratori të përkohshëm të falimentimit.

Kjo çështje është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 21.10.2019 nga pala kërkuese dhe ka qenë për shqyrtim pranë një tjetër trupi gjykues, i cili si i tillë është ndryshuar për shkaqe objektive/ligjore dhe pas rishortimit është paraqitur fashikulli gjyqësor pranë trupit të ri gjykues (gjyqtar Ervin Pollozhani) më datë 1.12.2020.

Gjatë kësaj periudhe kohore ka rezultuar se nga trupi tjetër gjykues ishin kryer veprimet paraprake dhe, konkretisht:

Me vendimin datë 7.2.2020 ishte bërë njoftimi i kërkesës së palës debitore shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., duke iu lënë një afat ligjor 10-ditor (dhjetëditor) asaj, sipas nenit 14 të ligjit nr. 110/2016, për të paraqitur kundërshtimet rreth kërkesës dhe provat respektive.

Ka rezultuar se nga shoqëria debitore nuk janë paraqitur kundërshtimet përkatëse dhe provat respektive, në lidhje me këtë objekt kërkesë, pasi që ka rezultuar me shënimin të dëftesa e komunikimit “larguar”.

Pas këtij veprimi ka rezultuar se gjykata, më datë 6.3.2020, ka vendosur të thërrasë në një seancë përgatitore palët, me qëllim për të marrë një informacion më të detajuar lidhur me shkaqet e hapjes ose jo të procedurës së falimentimit. Seanca përgatitore është caktuar për në datën 24.7.2020.

Në seancën përgatitore të kësaj date gjykata ka vlerësuar që është e nevojshme thirrja e një eksperteje, në referim të nenit 19/1/c, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, duke u caktuar në këtë mënyrë me këtë cilësi ekspertja Albana Canaj, e cila ka bërë betimin në këtë seancë dhe ka marrë detyrat respektive dhe në fund i është lënë një afat deri në datë 24.9.2020 për të dorëzuar përgjigjet e pyetjeve të aktit të ekspertimit.

Në këtë datë ekspertja ka dorëzuar aktin e ekspertimit për t’u njohur palët, ndërkohë që seanca vijuese është caktuar në datën 15.10.2020.



Seanca e kësaj date nuk është zhvilluar, për shkak të ndryshimit të trupit gjykues sa më sipër u citua dhe pas rishortimit çështja është paraqitur në këtë fazë pranë trupit të ri gjykues, i cili në referim të nenit 181 të K. Pr. Civile ka vlerësuar të vijoje veprimet në fazën në të cilën ato ndodhen.

Sa më sipër, në bazë të neneve 36, 41, 42 dhe 59 të K. Pr. Civile, si dhe neneve 3, 4, 9, 11, 16 e vijuese, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentin”, kjo gjykatë shqyrtoi nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil-tregtar dhe është në kompetencën e saj lëndore e tokësore dhe konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente nga pikëpamja e kompetencës lëndore e tokësore.

Gjithashtu, Gjykata, në vështrim të neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundërshtuar dhe nga pala prezente në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile, gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor deri në këtë fazë rezultoi e provuar, se:

Shoqëria “Marketing & Distribution” sh.p.k., pala kërkuuese (kreditore) në këtë gjykim, është person juridik i regjistruar në datën 8.9.1997, që ushtron veprimtarinë tregtare në fusha, si: “*të blejë apo të zotërojë në ndonjë mënyrë tjetër, të importojë, magazinojë, ruajë, eksportojë mallrat e ndryshme, përfshirë ato ushqimore, bujqësore e blegtorale, industriale etj*”.

Shoqëria “CMB Albania” sh.p.k. është regjistruar si person juridik më datën 24.3.2011. Me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, 16.4.2015, është vendosur ndryshimi i emrit të shoqërisë, nga “CMB Albania” në emrin “Qendra e Distribucionit Ushqimor”.

Pra, shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. është regjistruar si person juridik më datën 24.3.2011 dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj: “*Të gjitha dhe çdo aktivitet të shitjes me pakicë, dhënies me qira dhe shitjes, dhe blerjes së aktivitetëve të ndërtimit të pasurive të paluajtshme, drejtimi, administrimi dhe shfrytëzimi i supermarketeve dhe hipermarketeve, shitja me pakicë e produkteve ushqimore dhe joushqimore, prodhimi i produkteve ushqimore dhe joushqimore dhe transportimi dhe mbajtja e produkteve ushqimore dhe joushqimore, drejtimi i aktivitetëve të turizmit dhe të tjera, si dhe çdo veprimtari tjetër e ligjshme*”.

Midis palës kreditore dhe palës debitoare, pra shoqërisë “Marketing & Distribution” sh.p.k. dhe shoqërisë “CMB Albania” sh.p.k., sot “Qendra e Distribucionit Ushqimor” ka ekzistuar një marrëdhënie tregtare, ku pala kreditore me cilësinë e furnizuesit, ka furnizuar palën debitoare me artikuj të ndryshëm. Këto furnizime janë materializuar në fatura tatimore shitjeje objekt gjykimi, në një hark kohor të gjatë.

Në kushtet e mungesës së pagimit të detyrimit me kalimin e afatit të pagesës, pala kreditore shoqëria “Marketing & Distribution” sh.p.k. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë objekt gjykimi “Përmbushjen e detyrimit”.

Me vendimin nr. 7212, datë 20.9.2016, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *Pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., t’i paguajë shoqërisë “Marketing & Distribution” sh.p.k. shumën 25,626,009.12 lekë si detyrim i papërmbushur kontraktor.*

Me vendimin nr. regjistri themeltar 6300, datë 28.10.2016, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat tatimore me palë kreditore shoqërinë “Marketing & Distribution” dhe palë debitoare shoqërinë “Qendra e Distribucionit Ushqimor”.*

Me vendimin nr. 3958, datë 30.5.2019, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *Pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., t’i paguajë shoqërisë “Marketing & Distribution” sh.p.k. shumën 9,812,338.00 lekë si detyrim i papërmbushur kontraktor.*

Për të gjitha detyrimet e pasqyruara si më sipër, sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe pavarësisht faktit që pala kreditore i është drejtuar edhe shërbimit përmbarimor gjyqësor privat për të ekzekutuar vlerën e detyrimit ndaj palës debitoare shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., deri në momentin që i janë drejtuar gjykatës, nuk ka arritur të ekzekutojë detyrimin ndaj palës debitoare.

Nga ana tjetër, shoqëria “Interlogistic” sh.p.k. është regjistruar më datë 16.9.2007 si person juridik, sipas së drejtës shqiptare me nr. NIPT K21605003M, që ushtron veprimtarinë tregtare, në fusha si: “*Të blejë apo të zotërojë në ndonjë mënyrë tjetër, të importojë, magazinojë, ruajë, eksportojë apo tregtojë me shumicë dhe pakicë mallra të ndryshme, përfshirë ato ushqimore, bujqësore e blegtorale, industriale, lëndë të parë minerare, si dhe të çdo lloj malli tjetër. Të ushtrojë veprimtari*



të Duty Free Shop, në përputhje me dispozitat në fuqi. Shoqëria ka, gjithashtu, të drejtë të këtë pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare, si dhe të ndërmarrë çdo akt financiar, ekonomik apo tregtar të lidhur me objektin kryesor të saj dhe/ose që gjykohet i nevojshëm apo i leverdishëm për të etj.”

Midis palës kreditore dhe palës debitoare, pra shoqërisë “Interlogistic” sh.p.k. dhe shoqërisë “CMB Albania” sh.p.k., sot “Qendra e Distribucionit Ushqimor” ka ekzistuar një marrëdhënie tregtare, ku pala kreditore, me cilësinë e furnizuesit, ka furnizuar palën debitoare me artikuj të ndryshëm. Këto furnizime janë materializuar në fatura tatimore shitjeje.

Me vendimin nr. akti 5261, datë 9.9.2016, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat tatimore me palë kreditore shoqëria “Interlogistic” sh.p.k. dhe palë debitoare shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor”.

Me vendimin nr. akti 4920, datë 29.7.2016, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat tatimore me palë kreditore shoqërinë “Interlogistic” sh.p.k. dhe palë debitoare shoqërinë “Qendra e Distribucionit Ushqimor”.

Me vendimin nr. 7212, datë 20.9.2016, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: Pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., t’i paguajë shoqërisë “Interlogistic” sh.p.k. shumën 6,505,865.13 lekë si detyrim i papërmbyllur kontraktor.

Për të gjithë detyrimin e pasqyruar si më sipër, pala kreditore i është drejtuar edhe shërbimit përmbartimor privat për të ekzekutuar vlerën e detyrimit ndaj palës debitoare shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., por nuk ka arritur të ekzekutojë detyrimin ndaj palës debitoare.

Në cilësinë e kreditorit, duke marrë në konsideratë gjendjen e shoqërisë, e cila akoma nuk ka shlyer asnjë detyrim, pala kërkuese ka vlerësuar se shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. është në pamundësi financiare për të shlyer detyrimet ndaj palës kreditore dhe, në këto kushte, shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, prandaj ka kërkuar që të fillojë procedurat gjyqësore të falimentimit të saj.

E ndodhur në këtë gjendje financiare, shoqëria “Marketing & Distribution” sh.p.k. dhe shoqëria

“Interlogistic” sh.p.k. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar shpalljen e falimentimit, për shkak të paaftësisë paguese. Duke qenë se pala kërkuese është në cilësinë e kreditorit kundrejt palës tjetër e cila është debitoare ndaj saj, kërkuessit legjitimohen t’i drejtohen gjykatës për të kërkuar shpalljen e falimentimit të shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k.

Neni 13, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *“Fillimi i procedurës së falimentimit mund të kërkohej nga debitori ose kreditori në formë të shkruar dhe në përputhje me kërkesat e përvaktuara në këtë ligj.”*

Neni 16, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon se: *“Gjykata e falimentimit duhet të pranojë kërkesën e kreditorit, nëse kreditori provon se debitori është në gjendjen e paaftësisë paguese, për të paraqitur këtë kërkesë, kreditori duhet të provojë ekzistencën e një detyrimi të maturuar dhe të papaguar.”*

Gjendja e paaftësisë paguese prezumohet, në qoftë se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar, sipas parashikimeve të nenit 517, të Kodit të Procedurës Civile. Debitori, me anë të paraqitjes së provave, mund të kundërshtojë këtë prezumim nëse vërteton se ka aftësi paguese dhe se nuk ka një detyrim të maturuar e të papaguar ndaj kreditorit.”

Neni 21, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon se: *“Kur procedura e falimentimit ka filluar me kërkesë të kreditorit, debitorit i jepet 10 ditë kohë për t’i siguruar gjykatës së falimentimit të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.”*

Bazuar në sa më sipër, procedura e falimentimit mund të hapet për pasuritë e çdo personi juridik, vetëm kur ka një shkak ligjor. Në analizë të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, nga ana e palës kërkuese provohet se pala debitoare shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. është në paaftësi paguese, pasi, siç rezulton edhe nga provat shkresore palët kreditore kanë dështuar në ekzekutimin e detyrimit të njohur, sipas vendimeve gjyqësore, procedurë e cila është ndjekur sipas kriterëve ligjorë dhe përkatësisht nenit 517 të K. Pr. Civile.

Duke iu referuar rastit konkret, shkaku ligjor për hapjen e procedurës së falimentimit, i cili konsiston në mospagimin e detyrimeve në kohën e maturimit, është plotësuar e madje është tejkaluar.



Për më tepër, gjendja e paaftësisë paguese e shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. rezulton edhe nga informacioni që rezulton nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, i cili konfirmon shprehimisht pamundësinë e ekzekutimit të detyrimeve nga shoqëria.

Në kushtet kur shoqëria ka detyrime të papaguara ndaj autoriteteve tatimore dhe aktualisht nuk ushtron më asnjë aktivitet ekonomik, debitori nuk është në gjendje të paguajë detyrimet e maturuara.

Duke u ndodhur në këto kushte, pala kërkuese i është drejtuar me këtë kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar: Hapjen e procedurave të falimentimit për shoqërinë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. Caktimin e administratorit të përkohshëm të falimentit.

Në lidhje me parashikimet ligjore në përputhje me rastin konkret, Gjykata vëren se:

Neni 1, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Objekti i ligjit: “Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për të lehtësuar zgjidhjen dhe shyerjen kolektive të detyrimeve të debitorit në një procedurë falimentimi”.*

Neni 2, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Qëllimi i procedurës së falimentimit: “Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave.”.*

Neni 3, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Përkufizime: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:*

... 8. “Ekspert” është një profesionist i kualifikuar me njohuri të posaçme, të provuara në një fushë të caktuar, i pavarur nga palët dhe i regjistruar si i tillë në regjistrin e ekspertëve të mbajtur nga gjykata e falimentimit. Në rastet kur fusha e ekspertizës nuk mbulohet nga regjistri i ekspertëve të mbajtur nga gjykata e falimentimit, “Ekspert” do të kuptohet profesionisti i kualifikuar, me njohuri të posaçme të provuara në një fushë të caktuar, që paraqitet në një procedurë gjyqësore për të dhënë opinionin e tij të pavarur në atë fushë specializimi. Gjykata duhet të preferojë administratorët e falimentimit në funksionin e ekspertit.

9. “Gjykatë e falimentimit” është gjyqtari i vetëm i seksionit tregtar në gjykatën e rrethit gjyqësor, i ngarkuar me procedurat e falimentimit.

Neni 4, i ligjit, nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Parimi i legjislacionit të zbatueshëm: “1. Procedura e falimentimit rregullohet nga ky*

ligj. 2. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjeve të tjera zbatohen vetëm për çështje që nuk janë parashikuar në këtë ligj, për aq ato sa nuk bien në kundërshtim me të”.

Neni 5, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Parimi i eficiencës: “1. Procedura e falimentimit duhet të ndjekë një proces të rregullt, brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. 2. Procedura e falimentimit nuk pezullohet ose ndërpritet, përveç se kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj. 3. Vendimet dhe urdhrat e gjykatës së falimentimit janë menjëherë të zbatueshëm, përveç se kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj.”.*

Neni 6, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Parimi i transparencës dhe informimit: “1. Procedura e falimentimit është publike, brenda kufijve të përcaktuar nga ky ligj. 2. Palët pjesëmarrëse në procesin e falimentimit kanë të drejtë të informohen mbi procedurën, sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj.”.*

Neni 7, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Debitori në procedurën e falimentimit: “1. Procedura e falimentimit mund të fillojë ndaj çdo debitori si person fizik ose juridik. 2. Procedura e falimentimit mund të fillojë edhe pas prishjes së personit juridik që ende nuk është likuiduar. 3. Procedura e falimentimit nuk mund të fillojë ndaj subjekteve publike, objekt i së drejtës administrative. Shoqëritë me kapital publik ose shtetëror, të organizuara si person juridik privat, janë objekt i këtij ligji. 4. Ligji nuk zbatohet për shoqëritë e sigurimit, bankat, fondet e pensioneve, fondet e investimeve të letrave me vlerë dhe institucione të tjera që grumbullojnë depozita nga publiku ose institucione të tjera financiare, për të cilat procedura e falimentimit rregullohet në një ligj të posaçëm. Ky ligj zbatohet për institucionet jobankare, sipas parashikimeve të legjislacionit për bankat në Republikën e Shqipërisë. 5. Në rast të paaftësisë paguese të një subjekti që ushtron veprimtarinë e tij në një sektor strategjik të përcaktuar me ligj të posaçëm, si dhe të një subjekti që kryen një shërbim publik, zbatohet ky ligj nëse nuk rregullohet me një ligj të posaçëm ose kur rregullohet me një të tillë, por subjektit i është hequr licenca.”.*

Neni 8, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *E drejta e aksesit në informim: “1. Pas kërkesës me shkrim të paraqitur nga një palë pjesëmarrëse në procedurën e falimentimit, debitori, nëse mban të drejtën e administrimit gjatë procedurës së falimentimit ose administratori duhet t’i sigurojë palës dokumentacionin e falimentimit brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të kërkesës. 2. Dhënia e një informacioni të kërkuar, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të refuzohet me anë të një vendimi të arsyetuar, kur konstatohet se informacioni përmban të dhëna*



tregtare konfidenciale të debitorit dhe e vendos atë ose pasuritë e tij në një rrezik të lartë ose në raste të tjera të përcaktuara me ligj. 3. Pala pjesëmarrëse mund të paraqesë një ankim në gjykatën e falimentimit kundër vendimit për refuzimin e dhënë, sipas pikës 2 të këtij neni. Gjykata e falimentimit i cakton një afat 5-ditor debitorit ose administratorit për t'u shprehur në lidhje me këtë ankim. Gjykata e falimentimit jep vendim brenda 5 ditëve pas përgjigjes së debitorit ose administratorit”.

Neni 9, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: Juridiksioni i gjykatës së falimentimit: 1. “Procedura e falimentimit administrohet nga gjykata e falimentimit. Gjykata e falimentimit disponon me vendime dhe urdhra.

2. Gjykata e falimentimit mund të betojë me iniciativën e vet të gjitha aspektet e procedurës së falimentimit.

3. Gjykata e falimentimit është kompetente për gjykimin e të gjitha çështjeve që lidhen me procedurën e falimentimit dhe që ndikojnë në masën e falimentimit, duke përfshirë edhe: a) çdo padi të administratorit në lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike të debitorit; b) çdo padi në lidhje me përgjegjësinë e administrimit të debitorit; c) çdo padi në lidhje me njohjen dhe/ose kundërshtimin e kërkesave të kreditorit; ç) rastet që gjykata e falimentimit vepron sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 69, dhe pikës 3, të nenit 78, të këtij ligji.

4. Gjykata e falimentimit nuk është kompetente për të gjykuar për vazhdimin e rasteve, në të cilat debitori është në rolin e paditësit kundër palëve të treta. 5. Gjykata e falimentimit gjykon mbi prova shkresore në dhomë këshillimi. Përfundimisht, ajo gjykon në seancë dëgjimore vetëm kur është e nevojshme që të merren prova të reja, përveç atyre shkresore të depozituara. 6. Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit mbi kërkesën e kreditorit dhe paditë për kundërshtimin e veprimeve gjykohen në seancë dëgjimore.”.

Neni 11, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: Kompetenca territoriale: “1. Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe administrohet në gjykatën e falimentimit, ku debitori ka qendrën kryesore të interesit, vendbanimin ose vendqëndrimin kur është person fizik. Gjykata e falimentimit shqyrton me iniciativën e vet nëse ka juridiksion. 2. Në qoftë se një procedurë falimentimi është deklaruar nën kompetencën territoriale të disa gjykatave të falimentimit, kompetencë të drejtpërdrejtë për shqyrtimin dhe administrimin e çështjes ka gjykata e falimentimit ku është paraqitur për herë të parë kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit. 3. Nëse janë paraqitur disa kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit, në

lidhje me të njëjtin debitor, këto kërkesa do të bashkohen me kërkesën që është paraqitur e para.”.

Neni 12, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: Njoftimet dhe shpalljet: 1. “Njoftimet e vendimeve të gjykatës së falimentimit për fillimin e procedurës së falimentimit bëhen nga kjo gjykatë me shërbimin postar të shpejtë ose me mjete të komunikimit elektronik, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. 2. Përveç mënyrës së mësipërme të njoftimit, kur ky ligj ose gjykata e falimentimit kërkon një shpallje publike, kjo do të bëhet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në mënyrën dhe në vendet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, nëse nuk përcaktohet në këtë ligj. Këto shpallje publike do të konsiderohen njoftim për të gjitha palët që marrin pjesë në procedurën e falimentimit, përveçse kur ky ligj parashikon ndryshe. 3. Gjykata e falimentimit mund të kërkojë nga administratori që të kryejë të gjitha njoftimet dhe shpalljet e nevojshme, duke përfshirë, nëse është rasti, bërjen e tyre edhe në faqen zyrtare të internetit të debitorit. 4. Sekretaria e gjykatës njofton Agjencinë Kombëtare të Falimentimit për çdo kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, jo më vonë se 5 ditë nga data e paraqitjes së një kërkesë të tillë. 5. Sekretaria e gjykatës dërgon për publikim në Qendrën Kombëtare të Biznesit çdo vendim për fillimin, pezullimin dhe përfundimin e procedurës së falimentimit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. 6. Njoftimet dhe shpalljet përmbajnë informacion për debitorin dhe, në veçanti, adresën e vendbanimit ose vendin ku debitori ka qendrën kryesore të interesit, si dhe vendin ku ai ushtron veprimtarinë. 7. Gjykata e falimentimit mund të urdhërojë publikime të tjera të tilla, nëse e sheh të arsyeshme.”.

Neni 13, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin” parashikon: Kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit:

“Fillimi i procedurës të falimentimit mund të kërkohet nga debitori ose kreditorët në formë të shkruar dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.”.

Neni 16, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: Kërkesa e kreditorit:

1. Gjykata e falimentimit duhet të pranojë kërkesën e kreditorit, nëse kreditori provon se debitori është në gjendjen e paafësisë paguese. Për të paraqitur këtë kërkesë, kreditori duhet të provojë ekzistencën e një detyrimi të maturuar dhe të papaguar.

2. Gjendja e paafësisë paguese prezumohet në qoftë se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar, sipas parashikimeve të nenit 517, të Kodit të Procedurës Civile. Debitori, me anë të paraqitjes së provave, mund të kundërshtojë këtë prezumim nëse vërteton



se ka afësi paguese dhe se nuk ka një detyrim të maturuar e të papaguar ndaj kreditorit.”.

Neni 18, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin” parashikon: *Shqyrtimi i kërkesës së kreditorit: “1. Nëse kreditorët paraqesin kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit shqyrton kërkesën dhe kontrollon përputhshmërinë e saj me nenin 16 të këtij ligji. Nëse kërkesa është në përputhje me nenin 16, gjykata e falimentimit njofton debitorin për kërkesën brenda 5 ditëve, duke i bashkëngjitur një kopje të plotë të saj dhe të dokumenteve shoqëruese. 2. Debitori ka të drejtë të kundërshtojë me shkrim fillimin e procedurave të falimentimit brenda 10 ditëve nga momenti kur është njoftuar për kërkesën, duke siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të mbështetur pretendimet e tij. Në qoftë se debitori nuk e kundërshton në kohë fillimin e procedurës së falimentimit dhe nëse plotësohen kërkesat formale, gjykata e falimentimit deklaron fillimin e saj brenda 3 ditëve, në përputhje me nenin 29 të këtij ligji.”.*

Neni 19, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Procedura në rastin e kundërshtimit të kërkesës së kreditorit nga debitori:*

“1. Brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kundërshtimit për fillimin e procedurës së falimentimit nga debitori, gjykata e falimentimit: a) vendos datën e seancës gjyqësore dëgjimore, e cila do të mbahet jo më vonë se 30 ditë; b) thërret në seancë gjyqësore debitorin dhe kreditorin/ët kërkuar për fillimin e procedurës së falimentimit; c) nëse një nga palët kërkon caktimin e një eksperti, ose nëse gjykata e falimentimit konsideron të domosdoshme që të ketë një mendim nga ana e ekspertit për të vendosur mbi fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit vendos që të caktojë një ekspert ose një administrator të përkohshëm: i. për të verifikuar nëse ekzistojnë shkaqe për të filluar procedurën e falimentimit; ii. për të verifikuar nëse pasuritë e debitorit mund të mbulojnë kostot e procedurave të falimentimit; iii. për të mbikëqyrur veprimtaritë e debitorit; iv. për të dhënë një opinion nëse është e nevojshme të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë.

2. Gjkata e falimentimit mund t'i kërkojë ekspertit të sjellë mendime shtesë për aspekte të tjera të çështjes.

3. Gjatë gjykimit të çështjes, gjykata e falimentimit shqyrton nëse është e nevojshme vendosja e masave të përkohshme mbi pasuritë e debitorit, sipas nenit 22 të këtij ligji.

4. Gjykimi i çështjes nga gjykata e falimentimit duhet të përfundohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga data e seancës gjyqësore.

5. Gjkata e falimentimit mund të vendosë, brenda afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj, për: a) refuzimin e

kërkesës, për shkak të mungesës së shkaqeve ligjore për fillimin e procedurës së falimentimit; b) refuzimin e kërkesën për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit; ose c) pranimin e kërkesës dhe fillimin e procedurës së falimentimit dhe, në këtë rast, gjykata e falimentimit vendos sipas nenit 29 të këtij ligji.

Neni 20, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: *Rastet e mungesës së pasurisë: “1. Në rastet kur masa e falimentimit nuk ka pasuri të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit vendos për përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive.*

2. Përpara se të vendosë përfundimin e procedurës, gjykata e falimentimit informon kreditorët dhe bën shpallje publike të gjendjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në të gjitha autoritetet publike që, sipas rastit, kërkojnë nga ligji për të pasqyruar shënimet përkatëse. Kreditorët dhe palët e tjera të interesuara kanë të drejtë që brenda 60 ditëve nga ky njoftim të paraqiten në gjykatën e falimentimit dhe të kundërshtojnë përfundimin e procedurës, për shkak të mungesës së pasurive për arsyet e mëposhtme: a) nëse debitori ka pasuri; b) nëse betimi i mëtejshëm është i nevojshëm në lidhje me pasuritë që debitori ka transferuar dhe që mund të jetë subjekti i veprimit të shmangies, në përputhje me nenin 79 deri 81 të këtij ligji.

3. Gjkata e falimentimit, brenda 5 ditëve nga mbarimi i afatit të kundërshtimeve, i komunikon prokurorit çdo pretendim të palëve, të cilat kanë arsye të bazuara për nevojën e kryerjes së betimeve të mëtejshme mbi veprimet e debitorit, dhe pezullon procedurën për 6 muaj për kryerjen e betimit.

4. Gjkata e falimentimit vendos përfundimin e procedurës, për shkak të mungesës së pasurive nëse: a) nuk ka pasur kundërshtime për përfundimin e procedurës nga palët që mund të kundërshtojnë, pas kalimit të afatit 60-ditor; b) prokurori vendos mosfillimin ose pushimin e çështjes penale; c) kanë kaluar 6 muaj nga komunikimi që gjykata i bën prokurorit për pezullimin e procedurës.”.

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazës ligjore të kërkesës, si dhe përpos shpjegimeve të palës kërkuese dhe mendimit të ekspertes çmon, se referuar nenit 6 të K. Pr. Civile përcaktohet, se: *“Gjkata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohej dhe vetëm për atë që kërkohej”. Nga ana tjetër neni 16/1 përcakton, se: “Gjkata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore ...”. Gjkata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet, se: “Gjkata duhet të*



shprehet për të gjitha kërkesat që parashirohen në padi, pa i kaluar kushtet e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjor të tyre.

Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo të mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

Fillimi, në rrugë gjyqësore, i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit:

a) gjendje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim; ose

b) mbingarkesës së subjektit me borxhe.

Legjitimitimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit, e gëzon kreditori, debitori. Në rastet kur kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit paraqitet nga vete subjekti kreditor, ky i fundit duhet t'i evidentojë gjykatës listën e pasurive dhe të të ardhurave, listën e kreditorëve me vlerat respektive të detyrimit. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, Gjykata arrin në përfundimin se pala kërkuese legjitimohet të paraqesë këtë kërkesë, pasi ka cilësinë e kreditorit në procedurën e falimentimit.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 19/1/c të ligjit, me qëllim për të hetuar rreth pretendimeve të kërkuarit për ekzistencën e gjendjes së falimentimit të shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., Gjykata emëroi paraprakisht ekspertin Albana Canaj, së cilës iu caktuan si detyra:

Të verifikojë pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që mund të jenë të regjistruara në pronësi të shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k.;

Pas verifikimit dhe evidentimit të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme që mund të jenë të regjistruara në pronësi të shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. të përcaktohet nëse me anë të këtyre pasurive mund të mbulohen ose jo kostot e procedurës së falimentimit.

Të mbikëqyrë veprimtarinë e shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. duke përcaktuar nëse ushtron apo jo veprimtari tregtare aktualisht.

Të japë opinion nëse është apo jo e nevojshme që të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që gjenden të regjistruara në pronësi të shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k.

Nga raporti i paraqitur nga ekspertja, rezultuan këto përfundime:

Lidhur me pyetjen e parë është konkluduar pas shpjegimeve shteruese për të gjitha veprimet e kryera nga ekspertja, se: **Rezulton se ka mungesë të informacioneve financiare të domosdoshme për të gjykuar për pasuritë e debitorit. Bazuar në ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në standardet ndërkombëtare të auditit, si dhe në ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin” në mungesë për një periudhë mbi tri vite, të një informacioni financiar që sigurohet nga pasqyrat financiare, si dhe dokumentet mbështetëse mbi të cilat hartohen ato pasqyra, unë nuk mund të gjykoj nëse shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. ka pasuri të luajtshme apo të paluajtshme.**

Lidhur me pyetjen e dytë është konkluduar pas shpjegimeve shteruese për të gjitha veprimet e kryera nga ekspertja, se: **Gjendur në kushtet e mungesës së informacionit, nëse debitori shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. posedon apo jo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe në mungesë të mjeteve monetare, sipas të dhënave të siguruar nga bankat e nivelit të dytë, konkludoj se në këto kushte financiare nuk mbulohen kostot e procedurave të falimentimit.**

Lidhur me pyetjen e tretë është konkluduar pas shpjegimeve shteruese për të gjitha veprimet e kryera nga ekspertja, se: **Në kushte kur shoqëria nuk ka publikuar asnjë informacion tjetër financiar pas atij të vitit 2014, duke pasur detyrim ligjor për publikimin, konkludoj se nuk ekziston mundësia që shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. të zhvillojë aktualisht aktivitetet tregtar.**

Lidhur me pyetjen e katërt është konkluduar pas shpjegimeve shteruese për të gjitha veprimet e kryera nga ekspertja, se: **Në referim të përgjigjes së pyetjes 1 në mungesë të informacionit për sa**



u përket pasurive të disponuara nga shoqëria “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. nuk e gjykoj të nevojshme marrjen e masave të përkohshme për të siguruar pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme e cila nuk vërtetohet se ekziston.

Nga interpretimi i dispozitave të ligjit, Gjykata vëren se debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe, kur provohet se pasuritë e tij nuk evidentohen plotësisht në mënyrë që të gjykohet nëse ato do të mbulojnë detyrimet e maturuara ndaj të tretëve. Nga analiza e tërësisë së provave të administruara në gjykim, rezulton se aktivet e Shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k. nuk evidentohen për të vlerësuar nëse mjaftojnë apo jo për të paguar detyrimet ndaj kreditorëve dhe as shpenzimet e procedurës së falimentit.

Në lidhje me verifikimin e mundësisë për vazhdimësinë e veprimtarisë nga debitori, u provua nga ekspertja për shoqërinë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., se nuk gjendet informacion i mjaftueshëm ligjor që të provojë se ka likuiditete dhe pasuri, që të mund të rifillojë veprimtarinë e saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj.

Sa me lart, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e palëve kreditore çmohet si jo në përputhje me vetë qëllimin e procedurës së falimentimit, e cila sipas nenit 2, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, ka si qëllim të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave. Gjatë hetimit gjyqësor dhe, në veçanti, bazuar në përfundimet e aktit të ekspertimit, rezultoi se për palën debitore nuk evidentohet që të këtë masë falimentimi, e cila të mjaftojë për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit.

Çelja e procedurës së falimentimit, e cila duhej të kërkohej që në vitin 2016, pa ekzistencën e një mase falimentimi dhe në kushtet kur masa e falimentimit nuk mbulon as shpenzimet e procedurës, bën që kërkesa e kërkuësve të vlerësohet paraprakisht nga gjykata si e papranueshme në referim të nenit 20/1, të ligjit 110/2016, “Për falimentimin”.

Mungesa e një mase falimentimi dhe pamjaftueshmëria e saj (masës) në mbulimin e shpenzimeve të procedurës, sjell si pasojë rrëzimin e kërkesës për çeljen e procedurës së falimentimit

nga Gjykata e falimentimit, argumentim që është në përputhje dhe me interpretimin e nenit 99, pika 1/b dhe 5, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, të ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, ku rrëzimi i kërkesës për këtë arsye konsiderohet si një nga shkaqet për të kërkuar prishjen e shoqërisë dhe me pas çregjistrimin e saj.

Por, legjislatori me miratimin e ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, në nenin 20, paragrafi i dytë e vijues të tij, ka përcaktuar fazat respektive ligjore që ky moment procedural duhet të kalojë deri në vendimmarrjen përfundimtare të kërkesës për përfundimin e kësaj procedure, për shkak të mungesës së pasurisë.

Konkretisht, neni 20, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, parashikon: Rastet e mungesës së pasurisë: “1. Në rastet kur masa e falimentimit nuk ka pasuri të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit vendos për përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive.

2. Përpara se të vendosë përfundimin e procedurës, gjykata e falimentimit informon kreditorët dhe bën shpallje publike të gjendjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në të gjitha autoritetet publike që, sipas rastit, kërkojnë nga ligji për të pasqyruar shënimet përkatëse. Kreditorët dhe palët e tjera të interesuara kanë të drejtë që brenda 60 ditëve nga ky njoftim të paraqiten në gjykatën e falimentimit dhe të kundërshtojnë përfundimin e procedurës, për shkak të mungesës së pasurive për arsyet e mëposhtme: a) nëse debitori ka pasuri; b) nëse hetimi i mëtejshëm është i nevojshëm në lidhje me pasuritë që debitori ka transferuar dhe që mund të jetë subjekt i veprimit të shmangies, në përputhje me nenin 79 deri 81 të këtij ligji.

3. Gjykata e falimentimit, brenda 5 ditëve nga mbarimi i afatit të kundërshtimeve, i komunikon prokurorit çdo pretendim të palëve, të cilat kanë arsye të bazuara për nevojën e kryerjes së hetimeve të mëtejshme mbi veprimet e debitorit, dhe pezullon procedurën për 6 muaj për kryerjen e hetimit.

4. Gjykata e falimentimit vendos përfundimin e procedurës, për shkak të mungesës së pasurive nëse: a) nuk ka pasur kundërshtime për përfundimin e procedurës nga palët që mund të kundërshtojnë, pas kalimit të afatit 60-ditor; b) prokurori vendos mosfillimin ose pushimin e çështjes penale; c) kanë kaluar 6 muaj nga komunikimi që gjykata i bën prokurorit për pezullimin e procedurës.”

Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata në këtë fazë ka detyrimin ligjor që të shterojë gjitha etapat përkatëse që kjo dispozitë kërkon përpara vendimmarrjes së saj përfundimtare. Në këtë



kuptim ligji kërkon që procedura në këtë fazë të pezullohet si një mënyrë vendimarrjeje jopërfundimtare, sipas vetë frymës që përcjell formulimi i pikës së dytë të këtij neni. Pas këtij momenti, gjykata ka detyrimin që këtë vendim t'ua njoftojë subjekteve të përcaktuara në këtë dispozitë dhe, gjithashtu, ta publikojë me qëllim *“për t’u dhënë atyre të drejtën që brenda 60 ditëve nga ky njoftim të paraqiten në gjykatën e falimentimit dhe të kundërshtojnë përfundimin e procedurës, për shkak të mungesës së pasurive për arsyet e mëposhtme: a) nëse debitori ka pasuri; b) nëse hetimi i mëtejshëm është i nevojshëm në lidhje me pasuritë që debitori ka transferuar dhe që mund të jetë subjekt i veprimit të shmangies, në përputhje me nenet 79 deri 81 të këtij ligji”*.

Në varësi të kësaj faze gjykata do të procedojë me përcaktimet vijuese të dispozitës dhe vetëm pas shterimit të tyre në rend kronologjik do të mund të disponojë me vendimin e saj përfundimtar në kuptim të referimeve ligjore të bëra në nenet 19 dhe 20 të ligjit.

Sa më sipër, gjykata, çmon të pezullojë vijimin e mëtejshëm të kësaj procedure falimentimi, me qëllim bërjen e njoftimeve respektive në përmbushje të kërkesave ligjore për këtë rast, sipas përcaktimeve në dispozitivin e vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 1, 2, 3, 4, 5, 7, 9, 11, 13, 16 dhe 19, 20, të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”, dhe nenet 127, 306, 297 e vijues, 444 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pezullimin e vijimit të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., për shkak se plotësohen kërkesat ligjore të nenit 20 e vijues të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”.

2. Njoftimin e kreditorëve të njohur të shoqërisë “Qendra e Distribucionit Ushqimor” sh.p.k., konkretisht kërkuarve shoqëria “Marketing & Distribution” sh.p.k. dhe “Interlogistic” sh.p.k., që të paraqesin pranë gjykatës së falimentimit, sipas kërkesave ligjore të nenit 20 e vijues të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”, pretendimet e tyre brenda 60 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

3. Shpalljen publike të këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Kreditorët dhe palët e tjera të interesuara si më poshtë citohen kanë të drejtë që brenda 60 ditëve nga ky njoftim të paraqiten në gjykatën e falimentimit dhe të kundërshtojnë përfundimin e procedurës, për shkak të mungesës së pasurive për arsyet e mëposhtme:

a) nëse debitori ka pasuri;

b) nëse hetimi i mëtejshëm është i nevojshëm në lidhje me pasuritë që debitori ka transferuar dhe që mund të jetë subjekt i veprimit të shmangies, në përputhje me nenet 79 deri 81 të këtij ligji.

5. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi në Buletin e Njoftimeve Publike.

6. Një kopje e vendimit t'i njoftohet ekspertës së caktuar nga gjykata në lidhje me këtë procedurë, znj. Albana Canaj.

7. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

8. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim njoftimin e të gjitha drejtorive rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim kryerjen nga ana e tyre të veprimeve konform nenit 20, të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”.

9. Një kopje e vendimit t'u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë.

10. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë Rajonale Tiranë.

11. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe Drejtorisë Rajonale Tiranë.

12. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Tiranë.

13. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Përmbarimor, si dhe Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privat.

14. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Autoritetit Rrugor Shqiptar.

15. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

16. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.



17. Një kopje e vendimit t'i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

18. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

19. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqëse.

20. U shpall sot, më datë 16.3.2021, në Tiranë.

SEKRETARE
Lusjana Fezollari

GJYQTAR
Ervin Pollozhani

NJOFTIM

Nr. 67, datë 26.3.2021

PËR SHPALLJE KONKURRIMI PËR NJË VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", dhe të Kodit të Punës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë shpall konkurrimin për një vend të lirë pune (emërim i përkohshëm deri në rifillimin e punës nga ana e punonjësës aktuale, për arsye të lejes së barrë lindjes), në pozicionin sekretar gjyqësor, kategoria e pagës: IV-a.

Neni 44 (i ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016)

Sekretari gjyqësor

1. Sekretari gjyqësor kryen detyra procedurale, në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi.

2. Sekretari gjyqësor ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme:

a) vërteton aktet e gjykatës dhe lëshon vërtetime apo kopje të njësuara me origjinalin të akteve procedurale gjyqësore. Kur përdoren pajisje regjistrimi apo pajisje që kryejnë funksione të ngjashme, sekretari garanton që regjistrimi ose riprodhimi është origjinal dhe i paprekur;

b) është përgjegjës për krijimin e dosjeve dhe ndihmon gjyqtarin për mbajtjen e dosjeve, sipas një rregulli të caktuar, si dhe për regjistrimin dhe zbatimin e urdhrave të shpallur apo të nxjerrë nga gjykatat dhe gjyqtarët;

c) ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe për regjistrimet në regjistra dhe ndihmon në mbajtjen

dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;

ç) ndihmon në çështje që lidhen me mbajtjen e dosjeve personale;

d) bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe të tarifave gjyqësore;

dh) ndihmon në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kritereve të përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave;

e) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

3. Veprimtari të tjera, të cilat kryhen rregullisht nga sekretarët gjyqësorë, renditen në përshkrimet standarde të punës, miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:

1. Të jetë diplomuar në drejtësi;

2. Të ketë kryer të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën;

3. Të ketë aftësi të mira komunikuese;

4. Të ketë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit;

5. Eksperiencia në punë përbën avantazh;

6. Nota mesatare edhe kryerja e masterit përbën avantazh;

7. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqesë kandidati

Kandidati duhet të paraqesë pranë institucionit këto dokumente:

1. Kërkesë e kandidatit drejtuar institucionit;

2. Jetëshkrim i kandidatit;

3. Diploma universitare me listën e notave (kopje e noterizuar);

4. Fotokopje e kartës së identitetit, certifikatë personale me fotografi;

5. Libreza e punës;

6. Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se nuk është në procedim hetimor dhe gjyqësor;

7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim, sipas formës së kërkuar nga ligji;

8. Vërtetim vendbanimi;

9. Certifikatë/diplomë për njohuritë e kompjuterit (kopje e noterizuar);

10. Dëshmi të tjera kualifikimi nëse ka;

11. Raport mjekësor.



Të gjitha dokumentet duhet të jenë në origjinal ose të noterizuara.

Mosparaqitja e njërës prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht për skualifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri në datën 15.4.2021.

Intervista për kandidatët që do të kualifikohen do të zhvillohet pas njoftimit nga ana e Këshillit të Gjykatës në adresën elektronike dhe/ose nr. e telefonit të deklaruar nga kandidati.

KRYETARE E GJYKATËS
Esmeralda Xhili (Ceka)

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2021